



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA KUSHTETUESE  
USTAVNI SUD  
CONSTITUTIONAL COURT**

Prishtinë, më 24 qershor 2024  
Nr. Ref.: RK 2453/24

## **AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI**

në

**rastin nr. KI84/23**

Parashtrues

**Shahin Shahini**

**Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit [Rev.nr.223/2021] të Gjykatës  
Supreme të Kosovës të 31 marsit 2022**

### **GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare  
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar  
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare  
Safet Hoxha, gjyqtar  
Radomir Laban, gjyqtar  
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare  
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar dhe  
Enver Peci, gjyqtar dhe  
Jeton Bytyqi, gjyqtar

#### **Parashtruesi i kërkesës**

1. Kërkesa është parashtruar nga Shahin Shahini nga Komuna e Prishtinës (në tekstin e mëtejshëm: parashtruesi i kërkesës) i cili përfaqësohet para Gjykatës Kushtetuese nga Lindita Rexha, avokate nga Prishtina.

## **Vendimi i kontestuar**

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston kushtetutshmërinë e Aktgjykimit [Rev.nr.223/2021] të 31 marsit 2022, të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata Supreme), në lidhje me Aktgjykimin [AC.nr.1368/2017] e 28 dhjetorit 2020, të Gjykatës së Apelit të Kosovës (në tekstin në vijim: Gjykata e Apelit) dhe Aktgjykimin [C.nr.721/2013] e 23 janarit 2017, të Gjykatës Themelore në Gjiilan (në tekstin e mëtejme: Gjykata Themelore).
3. Parashtruesi i kërkesës Vendimin e kontestuar e ka pranuar më 20 shkurt 2023.

## **Objekti i çështjes**

4. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të kontestuar të Gjykatës Supreme, përmes të cilit pretendohet se parashtruesit të kërkesës i janë shkelur të drejtat dhe liritë të garantuara me nenin 31 paragrafi 1 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta).

## **Baza juridike**

5. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 (Procedimi i kërkesës) dhe 47 (Kërkesa individuale) të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 32 (Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve) të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).
6. Më 7 korrik 2023, Rregullorja e punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës Nr. 01/2023, u publikua në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe hyri në fuqi 15 ditë pas publikimit të saj. Rrjedhimisht gjatë shqyrtimit të kërkesës, Gjykata Kushtetuese i referohet dispozitave të Rregullores së lartcekur. Lidhur me këtë, konform Rregullit 78 (Dispozitat kalimtare) të Rregullores së punës Nr. 01/2023, përjashtimisht, dispozita të caktuara të Rregullores së punës Nr. 01/2018, do të vazhdojnë të zbatohen në lëndët e regjistruara në Gjykatë përpara shfuqizimit të saj, vetëm nëse dhe për aq sa janë më të favorshme për palët.

## **Procedura para Gjykatës Kushtetuese**

7. Më 19 prill 2023, parashtruesi i kërkesës ka dorëzuar kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
8. Më 3 maj 2023, Kryetarja e Gjykatës, përmes Vendimit [nr. GJR.KI84/23] emëroi gjyqtaren Selvete Gërzhaliu Krasniqi për Gjyqtare raportuese, ndërsa me Vendimin [nr. KSH.KI84/23], caktoi Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët: Radomir Laban si kryesues, Remzije Istrefi Peci, dhe Enver Peci (anëtarë).
9. Më 5 maj 2023, Gjykata e njoftoi Gjykatën Themelore për regjistrimin e kërkesës si dhe kërkoi nga ajo që ta bashkëlidhte fletëkthesën që dëshmonte datën e pranimit të Vendimit të kontestuar nga ana e parashtruesit të kërkesës.
10. Më 5 maj 2023, Gjykata e informoi parashtruesin e kërkesës për regjistrimin e kërkesës dhe në të njëjtën ditë i dërgoi një kopje të kërkesës Gjykatës Supreme.

11. Më 15 maj 2023, Gjykata Themelore dorëzoi në Gjykatë fletëkthesën, që dëshmon se parashtruesi i kërkesës e kishte pranuar Aktgjykimin e kontestuar më 20 shkurt 2023.
12. Më 11 mars 2024, gjyqtari Jeton Bytyqi dha betimin para Presidentes së Republikës së Kosovës, me ç' rast filloi mandati i tij në Gjykatë.
13. Më 28 maj 2024, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtares raportuese dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës rekomandim papranueshmërinë e kërkesës.

### **Përmbledhja e fakteve**

14. Nga shkresat e lëndës, rezulton që parashtruesi i kërkesës kishte punuar në ish ndërmarrjen shoqërore N.Sh. "Kosovatrans" - Ndërmarrja për Trafikun e Udhëtarëve në Gjilan, e cila më pas e kishte ndryshuar emrin "Kosmet Prevoz" nga Gjilani, në vendin e punës si konduktor. Ndërmarrje kjo që, me vendimin [nr. 470] të datës 16 prill 1991 i kishte ndërprerë marrëdhënien e punës parashtruesit të kërkesës, me arsyetimin se ai kishte refuzuar të nënshkruajë deklaratën mbi pranimin e masave të përkohshme në këtë ndërmarrje, dhe se si pasojë e kësaj parashtruesi i kërkesës kishte filluar procese gjyqësore, me qëllimin për t'u kthyer në punë dhe në lidhje me kompensimin e të ardhurave personale.
15. Për të afirmuar të drejtat e tij në këtë çështje, parashtruesi i kërkesës kishte vazhduar me procese gjyqësore, e që si pasojë Gjykata, do të paraqesë faktet e këtyre proceseve, si në vijim.

### *Procedura e parë gjyqësore*

16. Më 15 maj 1991, parashtruesi i kërkesës ushtroi padi në Gjykatën Themelore të Punës së Bashkuar në Prishtinë, përmes së cilës propozoi shfuqizimin e vendimit lidhur me ndërprerjen e marrëdhënies së punës dhe pagesën e të ardhurave, kundër ish-N.Sh. "Kosovatrans" - Ndërmarrja për Trafikun e Udhëtarëve në Gjilan.
17. Më 15 nëntor 1996, Gjykata Komunale në Prishtinë, nëpërmjet Aktvendimit [C.nr.1355/92] ishte shpallur jo kompetente për të trajtuar çështjen dhe ia kishte transferuar atë për procedim të mëtejshëm Gjykatës Komunale në Gjilan, si gjykatë me kompetencë lëndore dhe territoriale.
18. Më 29 tetor 1997, Gjykata Komunale në Gjilan, nëpërmjet Aktgjykimit [C.nr.333/97], e kishte refuzuar kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës si të pabazuar me ligj.
19. Më 20 shkurtit 1998, Gjykata e Qarkut në Gjilan, përmes Aktvendimit [Ac.nr.116/98], duke u bazuar në ankesën e parashtruesit të kërkesës, kishte shfuqizuar aktgjykimin e instancës gjyqësore të shkallës së parë dhe kishte kthyer çështjen për rigjykim.

### *Procedura e dytë gjyqësore*

20. Bazuar në shkresat e lëndës Gjykata vëren se në rigjykim të çështjes, më 01 shtatorit 1998, Gjykata Komunale në Gjilan, përmes Aktgjykimit [C.nr.207/98] e kishte refuzuar si të pabazuar kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës.
21. Më 25 janar 1999, Gjykata e Qarkut në Gjilan përmes Aktgjykimit [Ac.nr.22/99] vërtetoi aktgjykimin e lartcekur të Gjykatës Komunale në Gjilan.

22. Në një datë të pacaktuar, parashtruesi i kërkesës dorëzoi kërkesë për revizion për shkak të (i) shkeljes thelbësore të dispozitave të procedurës dhe (ii) zbatimit të gabuar të së drejtës material.
23. Në vitin 2000, krahas këtyre, duhet theksuar se N.Sh. "Kosovatrans", i është nënshtruar transformimit nga ana e Agjencionit Kosovar të Privatizimit.
24. Më 19 tetor 2006, Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit [Rev.nr.68/2006] kishte aprovuar kërkesës për revizion të parashtruesit të kërkesës, përmes të cilit ishte ndryshuar Aktgjykimi [Ac.nr. 22/1999] i 25 janarit 1999, i Gjykatës së Qarkut Gjilan, dhe Aktgjykimi [C.nr. 207/1998] i 1 shtatorit 1998, i Gjykatës Komunale Gjilan, ashtu që ishte anuluar si i kundërligjshëm vendimi i të paditurës [nr.470] i 16 prillit 1981 dhe vendimi [nr. 577] i 8 majit 1991, me të cilat parashtruesit të kërkesës i ishte ndërprerë marrëdhënia e punës dhe e paditura Ndërmarrja Shoqërore e Komunikacionit të Udhëtarëve "Kosova Trans" në Gjilan, ishte detyruar që të njëjtin ta kthejë në punë në detyrat e punës si konduktor, ndërsa pjesën e kërkesëpadisë së tij për kompensim të të ardhurave personale e kishte kthyer në rigjykim tek gjykata e shkallës së parë.

#### *Procedura e tretë gjyqësore*

25. Më 17 nëntor 2010, Gjykata Komunale në Gjilan përmes Aktgjykimit [C.nr.95/07]: (I) aprovoi si të bazuar kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës, e ushtruar kundër të paditurës KTU "Kosovatrans" nga Gjilan, dhe obligohet e paditura që paditësit të ia kompenzojë të ardhurat personale për periudhën kohore prej datës 16 prill 1991, deri më datë 26 gusht 1999, për shkak të largimit të kundërligjshëm nga puna në shumë prej 18.479 euro dhe kamatën në lartësi prej 3.674 euro, e në shumë të përgjithshme prej 22.153 (njëzet e dy mijë e njëqind e pesëdhjetë e tri) euro; (II) Secila palë i bartë shpenzimet e veta të procedurës, ndërsa në mënyrë të barabartë për hartimin e aktgjykimit shumë prej 60 euro, krejt këtë në afat prej 15 ditësh nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi.
26. Pas ankesës së parashtruar nga përfaqësuesi i të paditurit kundër aktgjykimit të, më 18 shtator 2013, Gjykata e Apelit përmes Aktvendimit [CA.nr.745/2012], e kishte prishur aktgjykimin e lartcekur dhe lëndën e kishte rikthyer në rigjykim për vendosje, *për të marrë një vendim duke e urdhëruar gjykatën e shkallës së parë ta vërtetojë legjitimitetin pasiv të palës së paditur, respektivisht a është suksesor i saj, pas transformimeve dhe regjistrimeve pas vitit 1999.*

#### *Procedura e katërt gjyqësore*

27. Më datë 23 janar 2017, Gjykata Themelore në Gjilan, përmes Aktgjykimit [C.nr.721/2013]: aprovoi si të bazuar kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës ndaj të paditurës N.P.L "Stacioni i Autobusëve" sh.a. Gjilan; (I) obligohet e paditura NPL "Stacioni i Autobusëve" sha. në Gjilan që paditësit t'ia kompenzojë të ardhurat personale në lartësi bruto prej 18.479.00€, për periudhën kohore nga 16 prilli 1991 e deri më 26 qershor 1999, në vendin e punës konduktor, në ish N.SH. "Kosovatrans" në Gjilan me kamatë bankare ashtu siç kanë paguar institucionet financiare në Kosove, për mjetet e deponuara mbi një vit pa destinim të veçantë nga 15 maji 1991 deri në muajin dhjetor 2012, kurse pas hyrjes në fuqi të LMD-së nga 1 janar 2013, t'ia paguaj kamatën prej 8% në vit të gjitha në afat prej 7 ditësh pas ditës së pranimit të vendimit nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm; (II) Secila palë i bartë shpenzimet e veta gjyqësore, kurse e paditura detyrohet që kësaj gjykate t'ia paguajë shumë e të hollave në lartësi prej 75€, në emër të përpilimit të vendimit, në afat prej 7 ditësh pas ditës së pranimit të vendimit nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

28. Në një datë të paspecifikuar, kundër aktgjykimit të lartcekur, në afatin ligjor kishte paraqitur ankesë e paditura, për shkak të konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozimin që aktgjykimi i ankimuar të prishet dhe çështja ti kthehet gjykatës së shkallës së parë në rivendosje.
29. Përgjigje në ankese paraqiti parashtruesi i kërkesës me propozimin që ankesa e të paditurës të refuzohet si e pa bazuar dhe aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet.
30. Më datë 28 dhjetor 2020, Gjykata e Apelit, nëpërmjet Aktgjykimit [Ac.nr.1368/17] kishte refuzuar si të bazuar ankesën e palëve të paditur, NPL "Stacioni i Autobusëve" Sh.A. dhe vërtetoi Aktgjykimin [C.nr.721/2013] e 23 janarit 2017, të Gjykatës Themelore të Gjilanit.
31. Më datë 11 shkurt 2021, bazuar në shkresat e lëndës Gjykata vëren se kundër këtij Aktgjykimi, i padituri kishte paraqitur kërkesë për revizion në Gjykatën Supreme, për shkak të shkeljes thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të aprovohet si i bazuar revizioni i tij, ndërsa të anulohen të dy aktgjykimet e lartpërmendura dhe lënda t'i bartet në rigjykim dhe rivendosje Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme.
32. Në përgjigje në revizionin e të paditurës, parashtruesi i kërkesës i kontestoi në tërësi thëniet e revizionit dhe propozoi që revizioni i të paditurës të refuzohet si i pabazuar.
33. Më 31 mars 2022, Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit [Rev.nr.223/2021] aprovoi pjesërisht si të bazuar revizionin e të paditurës, i paraqitur kundër Aktgjykimit [AC.nr. 1368/2017] i 28 dhjetorit 2020, të Gjykatës së Apelit, dhe ndryshohet i njëjti aktgjykim, si dhe Aktgjykimi [C.nr.721/2013] i 23 janarit 2017, i Gjykatës Themelore në Gjilan, ashtu që refuzohet në tërësi si e pabazuar kërkesëpadia e parashtruesit të kërkesës që të detyrohet e paditura që paditësit t'i paguajë të ardhurat personale në lartësi bruto prej 18,479.00 euro, për periudhën kohore nga data 16.04.1991 e deri më datën 26.06.1999, në vendin e punës konduktor në ish N.Sh. "Kosovatrans" në Gjilan, [...].
34. Tutje, Gjykata Supreme, në arsyetimin e saj, kishte theksuar si në vijim:

*"Gjykata Supreme konstaton se zbatimi i gabuar i se drejtës materiale ne këtë rast lidhet me faktin se e paditura si subjekti nga data 15.06.2012, në bazë të Ligjit Nr. 04/L-111 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike (i shpallur në Gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës nr. 13 datë 30.05.2012, hyrja në fuqi pas 15 ditësh pas shpalljes ) sipas listës 2, është me status të ndërmarrjes publike ku në pronësi të 100% të aksioneve është Komuna e Gjilanit, e cila në këtë kontest nuk është në cilësinë e palës së paditur. Për këtë arsye Gjykata Supreme konsideron se e paditura nuk ka legjitimitet pasiv për të qenë palë e paditur në këtë çështje ngase tani më ajo është ndërmarrje publike në pronësi të Komunës së Gjilanit, në të cilën ligjërisht janë bartur të gjitha të drejtat dhe obligimet e saj."*

*"Për më tepër, Gjykata Supreme gjen edhe se qëndron fakti se janë të kundërligjshme vendimet kontestuese me të cilat i është ndërprerë marrëdhënia e punës së paditësit në vitin 1991, ashtu siç ka konstatuar Gjykata Supreme e Kosovës me aktgjykimin e saj [Rev.nr. 68/2006] datë 25.01.1999, mirëpo tani e paditura nuk mund të ketë legjitimitet pasiv për të qenë e detyruar që paditësit t'ia paguajë të ardhurat personale kontestuese ngase përveç faktit që e paditura tani me është ndërmarrje publike në pronësi të Komunës së Gjilanit, ajo nuk ia ka ndërprerë paditësit marrëdhënien e punës, por ia ka ndërprerë paraardhësja e saj "Kosmet*

*Prevoz" e cila tani më nuk ekziston, e as nuk ka ekzistuar dhe funksionuar pas vitit 1999, në njërin anë, ndërsa në anën tjetër "Kosovatransi", i cili si ndërmarrje ka ekzistuar më parë tek e cila ka qenë i punësuar paditësi, e pasardhës i saj është " Kosmet prevozi", nuk mban përgjegjësi për veprimet e kundërligjshme të ndërmarrjes "Kosmet Prevoz". Pas vitit 1999 "Kosovatransi" i Gjilanit, është krijuar si subjekt i ri, duke mos trashëguar borxhet dhe detyrimet e "Kosmet Prevozit" e cila në rastin konkret në bazë të aktgjykimit të lartpërmendur të Gjykatës Supreme të Kosovës kishte pas për detyrim sikur ekzistonte, që paditësit t'ia kompensoj të ardhurat personale. Kjo do të thotë që edhe për këto arsye, e paditura nuk ka legjitimitet pasiv, ndaj, edhe nuk është e detyruar që paditësit t'i kompensojë të ardhurat personale për periudhën kohore 1991-1999 pasi që këtë dëm material paditësit ajo nuk ia ka shkaktuar, atë ia ka shkaktuar një subjekt tjetër ekonomik."*

#### *Procedura Përmbartimore e iniciuar nga parashtruesi i kërkesës*

35. Më 22 shkurt 2021, parashtruesi i kërkesës paraqiti propozim për lejimin e Përmbartimit në Gjykatën Themelore në Gjilan, në bazë të dokumentit përmbartimor – Aktgjykimit [C.nr.721/2013] të 23 janarit 2017, të Gjykatës Themelore, i plotfuqishëm me 28 dhjetor 2020 dhe i ekzekutueshëm më 28 shkurt 2021, aktgjykim ky i vërtetuar edhe me Aktgjykimin [Ac.nr.1368/2017] e 28 dhjetorit 2020, të Gjykatës së Apelit.
36. Më 19 mars 2021, Gjykata Themelore përmes Aktvendimit [CP.nr.62/2021], lejoi përmbartimin e propozuar të parashtruesit të kërkesës, në bazë të dokumentit përmbartimor – Aktgjykimit [C.nr.721/2013] të 23 janarit 2017, të Gjykatës Themelore.
37. Më 29 mars 2021, e paditura kishte paraqitur prapësim, ndërsa më 29 prill 2021, parashtruesi i kërkesës dorëzoi përgjigje në prapësim duke kërkuar nga gjykata që të refuzojë prapësimin dhe të lejë në fuqi urdhrin përmbartimor, pasi që kërkesa e debitorit është e paarsyeshme.
38. Më 30 prill 2021, Gjykata Themelore përmes Aktvendimit [CP.nr. 62/21] (I) refuzoi si të pabazuar prapësimin e 29 marsit 2021, të debitorit N.P.L. "Stacioni i Autobusëve" Sh.A., të paraqitur kundër Urdhrit për Përmbartim [CP.nr.62/21] të 19 marsit 2021, i lejuar nga kjo gjykatë dhe i njëjti urdhrë mbetet në fuqi; (II) Detyrohet debitori N.P.L. "Stacioni i Autobusëve" Sh.A. që parashtruesit të kërkesës t'i paguaj shpenzimet e kësaj procedure në shume prej 412.00€.
39. Kundër aktvendimit të lartcekur, në afatin ligjor ka ushtruar ankesë debitori, me të cilën kundërshtonte në tërësi aktvendimin duke propozuar që Gjykata e Apelit ta prishë aktvendimin e gjykatës së shkallës së parë dhe ta shfuqizojë aktvendimin për lejimin e përmbartimit, apo ta shtyjë përmbartimin derisa Gjykata Supreme e Kosovës, do të vendosë lidhur me revizionin e paraqitur kundër Aktgjykimit [C.nr.721/2013] të 23 janarit 2017, të Gjykatës Themelore dhe Aktgjykimit [Ac.nr.1368/2017] të 28 dhjetorit 2020, të Gjykatës së Apelit, si dokument përmbartues ose çështja të kthehet në procedim të serishëm dhe rivendosje.
40. Përgjigje në ankesë paraqiti parashtruesi i kërkesës me propozim që ankesa e debitorit të refuzohet si e pa bazuar ndërsa Aktvendimi i Gjykatës Themelore të vërtetohet.
41. Më 10 maj 2022, Gjykata e Apelit përmes Aktvendimit [Ac.nr.3855/21] refuzoi si të pathemeltë ankesën e debitorit N.P.L "Stacioni i Autobusave" Sh.A, ndërsa vërtetoi Aktvendimin [Cp.nr.62/2021] e 30 prillit 2021, të Gjykatës Themelore. Në arsyetimin e aktvendimit të saj, Gjykata e Apelit arsyetoi si në vijim: *"Gjykata e Apelit i vlerësoi pretendimet ankimore lidhur me propozimin për shtyrje të përmbartimit, për arsye se pala debitore kishte parashtruar revizion në Gjykatën Supreme të Kosovës, mirëpo*

*Gjykata e Apelit nuk mund ta merr këtë pretendim si të bazuar për faktin se paraqitja e mjetit të jashtëzakonshëm nuk është arsye për shtyrje të përmbarimit dhe se neni 231 i LPK-së përcakton se: "Revizioni i paraqitur nuk është pengesë për përmbarimin e aktgjykimit të formës së prerë të goditur".*

42. Më datë 29 gusht 2022, Gjykata Themelore e Gjilanit përmes Aktvendimit [CP.nr.62/2021] përfundoi procedurën përmbarimore të parashtruesit të kërkesës, kundër debitorit N.P.L "Stacioni i Autobusëve" sh.a, sipas propozimit të 22 shkurt 2021, për përmbarimin e dokumentit përmbarimor - Aktgjykimit [C.nr.721/2013], lidhur me pagesën e të ardhurave personale, në lartësi prej 18,479.00 €. Tutje, në arsyetimin e saj ajo kishte theksuar si në vijim:

*"Debitori N.P.L "Stacioni i Autobusëve" sh.a, me seli në Gjilan, përmes përfaqësuesit të tij F. M., me dt.14.02.2021, ka ushtruar revizion në Gjykatën Supreme të Kosovës në Prishtinë, kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, Ac.nr.1368/2017, të dt.28.12.2020, dhe aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjilan, C.nr.721/2013, të dt.23.01.2017, duke i ndryshuar të njëjtat aktgjykime, ashtu që ka refuzuar në tërësi si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësit Shahin Shahini nga Prishtina, të paraqitur kundër të paditurës N.P.L. "Stacioni i Autobusëve" sh.a., me seli në Gjilan.*

*Pas kthimit të lëndës nga Gjykata Supreme e Kosovës, kjo gjykatë duke u bazuar në aktgjykimin e gjykatës së revizionit Re.nr.223/2021, të dt.31.03.2021, dhe duke vepruar sipas detyrës zyrtare, ka përfunduar procedurën përmbarimore."*

#### **Pretendimet e parashtruesit të kërkesës**

43. Parashtruesi i kërkesës pretendon se Gjykata Supreme nëpërmjet Aktgjykimit të saj [Rev.nr.223/2021] 31 marsit 2022, ka shkelur Nenin 31 paragrafi 1 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], i cili garantohet në Kushtetutën e Republikës së Kosovës.
44. Sipas parashtruesit të kërkesës, Gjykata Supreme, me vendimin e saj, ka bërë shkelje të drejtave e tij pasi që nuk ka zbatuar saktësisht të drejtën materiale, për arsye se faktet vendimtare që kanë ndikuar në marrjen e vendimit të këtij Aktgjykimi janë në kundërshtim me ligjin në të cilin bazohet Gjykata, në argumentimin e saj.
45. Tutje, parashtruesi i kërkesës thekson se Gjykata Supreme ka refuzuar kërkesëpadinë e tij me argumentin: *"[...] pala e paditur, si subjekt nga data 15 qershor 2012, është me status të ndërmarrjes publike, ku në pronësi të 100% të aksioneve është Komuna e Gjilanit, e cila në këtë kontest nuk është në cilësinë e palës së paditur"*, duke konsideruar se e paditura nuk ka legjitimitet pasiv. Tutje parashtruesi i kërkesës pretendon se Gjykata Supreme në këtë rast bie në kundërshtim me Ligjin për Ndërmarrje Publike 03/L-087, veçanërisht me Nenin 39, Pika 2, i cili thotë: *"Nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të gjitha borxhet dhe detyrimet e papaguara financiare të Shoqërisë Holding do t'i barten dhe do të merren përsipër nga NP e cila njëkohësisht me inkorporimin e saj si shoqëri aksionare sipas Rregullores së UNMIK-ut 2001/6, ka marrë pronësinë ose posedimin e të gjitha ose një pjese të konsiderueshme të aseteve operative dhe të tjera të ndërmarrjes e cila fillimisht ka hyrë në këtë borxhe ose detyrime; me kusht që nëse këto asete i janë bartur më shumë se një shoqërie aksionare, atëherë secili shoqëri e këtillë do të jetë bashkërisht dhe individualisht përgjegjëse për borxhet dhe detyrimet e pambushura të ndërmarrjes e cila fillimisht i kishte krijuar këto borxhe ose detyrime, dhe secila shoqëri e këtillë ka të drejtë të pranojë kontribute nga të tjerat nëse asaj i kërkohet që të paguajë ose për ndryshe të pambushë me shumë se pjesën e saj të këtyre borxheve ose detyrimeve (pjesa e saj është e barabartë me përqindjen, e përcaktuar në bazë të vlerës, të aseteve të ndërmarrjes fillestare të cilat i janë bartur kësaj shoqërie)."*

46. Tutje parashtruesi i kërkesës pretendon se ajo që e bën të qartë se e paditura ka legjitimitet pasiv për të qenë palë e paditur është fakti se të gjitha borxhet dhe detyrimet e papaguara financiare janë marrë përsëri nga Ndërmarrja Publike. Për faktin se, kjo ndodh për shkak të transferimit të pronësisë së subjektit të paditur, duke marrë parasysh se subjekti i palës së paditur nuk është shuar e as nuk ka falimentuar, por vetëm është ndryshuar pronari i cili i ka marrë mjetet, të drejtat dhe obligimet e subjektit të pronarit paraprak.
47. Sipas parashtruesit të kërkesës është e rëndësishme të theksohet se çështja e legjitimitetit të palës ka qenë e vendosur nga vetë Gjykata Supreme, e cila e ka konfirmuar me Aktgjykimin [Rev.nr.68/2006] e 19 tetorit 2006. Me këtë aktgjykim, ishte ndryshuar Vendimi i Gjykatës së Qarkut në Gjilan [Ac.nr.22/1999] i 25 janarit 1999 dhe Vendimi i Gjykatës Komunale në Gjilan [C.nr.207/1998] i 1 shtatorit 1998, në të cilat vendimet e të paditurës [nr.470], të 16 prillit 1991 dhe Vendimi [nr.577] të 8 majit 1991, me të cilat parashtruesit të kërkesës i ishte ndërprerë marrëdhënia e punës në mënyrë të kundërligjshme. Sipas parashtruesit të kërkesës në çështja ishte rikthyer në rigjykim, vetëm sa i përket caktimit të kompensimit të të ardhurave personale, në gjykatën e shkallës së parë. Ky konstatim ishte konfirmuar edhe nga Gjykata Themelore në Aktgjykimin [C.nr.721/2013] e 23 janarit 2017 dhe nga Gjykata e Apelit me Aktgjykimin [Ac.nr.1368/117] e 28 dhjetorit 2020, duke vënë theksin edhe një herë tek neni 10 i Statutit të të paditurës, në të cilin përcaktohet: “*e paditura është trashëgimtare e Ndërmarrjes Shoqërore Stacioni i Autobusëve në Gjilan dhe është përgjegjëse për borxhet dhe detyrimet tjera me tërë asetet dhe pasurinë e saj, ku trashëgon të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësitë që vijnë si rezultat i këtij transformimi*”, duke e vlerësuar faktin e legjitimitetit të paditurit si jo kontestues.
48. Duke marrë parasysh këto rrethana, parashtruesi i kërkesës konsideron se **arsyetimi** për refuzimin e kërkesëpadisë nga ana e Gjykatës Supreme të Kosovës, është i pa bazuar dhe jo në harmoni me të drejtën materiale. Tutje, parashtruesi i kërkesës thekson: “*Kjo për faktin se në këtë çështje juridike gjykata është dashur të aplikojë dispozitën e nenit 39 pika 2 të Ligjit për Ndërmarrje Publike -03/L-087 dhe t’ia vërtetojë paditësit të drejtën për kompensimin e të ardhurave personale, e drejtë kjo që i është mohuar paditësit padrejtësisht, dhe i njëjti orvatet tash e 30 vite nëpër Gjykatat e Kosovës me shpresën se do t’i mundësohet realizimi i të drejtës së tij.*”.
49. Sipas parashtruesit të kërkesës, Gjykata Supreme, duke marrë dy vendime të ndryshme dhe kontradiktore në dy raste të ndryshme të revizionit, ka shkelur rëndë parimin e sigurisë juridike të palëve në procedurë. Dhe se, në këtë situatë, ku gjithë procesi ka kaluar nëpër shumë instanca gjyqësore të ndryshme dhe është vërtetuar disa herë e drejta e parashtruesit të kërkesës për kompensimin e të ardhurave personale, dhe që si pasojë kërkon anulimin e Vendimit të Gjykatës Supreme, duke e lënë në fuqi Aktvendimin e plotfuqishëm mbi lejimin e përmbarimit.

## Dispozitat relevante kushtetuese dhe ligjore

### KUSHTETUTA E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

#### Neni 31

#### [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]

“1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.

[...]”



## LIGJI NR. 03/L-087 PËR NDËRMARRJET PUBLIKE

### Neni 39

#### Disponimi me Aksionet dhe Detyrimet e Mbajtura ose Paraprakisht të Marra Përsipër nga Shoqëritë Holding

[...]

39.2. Nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të gjitha borxhet dhe detyrimet e papaguara financiare të Shoqërisë Holding do t'i barten dhe do të merren përsipër nga NP e cila njëkohësisht me inkorporimin e saj si shoqëri aksionare sipas Rregullores së UNMIK-ut 2001/6, ka marrë pronësinë ose posedimin e të gjitha ose një pjese të konsiderueshme të aseteve operative dhe të tjera të ndërmarrjes e cila fillimisht ka hyrë në këtë borxhe ose detyrime; me kusht që nëse këto asete i janë bartur më shumë se një shoqërie aksionare, atëherë secili shoqëri e këtillë do të jetë bashkërisht dhe individualisht përgjegjëse për borxhet dhe detyrimet e pa përmbushura të ndërmarrjes e cila fillimisht i kishte krijuar këto borxhe ose detyrime, dhe secila shoqëri e këtillë ka të drejtë të pranojë kontribute nga të tjerat nëse asaj i kërkohet që të paguajë ose për ndryshe të përmbushë me shumë se pjesën e saj të këtyre borxheve ose detyrimeve (pjesa e saj është e barabartë me përqindjen, e përcaktuar në bazë të vlerës, të aseteve të ndërmarrjes fillestare të cilat i janë bartur kësaj shoqërie).

[...].”

## LIGJI Nr. 04/L-111 PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT Nr. 03/L-087 PËR NDËRMARRJET PUBLIKE

### Neni 23

[...]

1. Lista 1 Ndërmarrjet Publike Qendrore në ligjin bazik fshihet dhe riformulohet si në vijim:

15. Stacioni i Autobusëve Gjilan, Gjilani 100%.

[...]

#### Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

50. Gjykata së pari shqyrton nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të cilat janë të përcaktuara me Kushtetutë, të parashikuara me Ligj dhe të specifikuar më tej me Rregullore të Punës.
51. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

[...]

52. Gjykata i referohet edhe neneve 47 (Kërkesa individuale), 48 (Saktësimi i kërkesës) dhe 49 (Afatet) të Ligjit, që përcaktojnë:

*Neni 47  
(Kërkesa individuale)*

*“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.*

*2. Individ i mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.*

*Neni 48  
(Saktësimi i kërkesës)*

*“Parashtruesja e kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestojë”.*

*Neni 49  
(Afatet)*

*“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajsh. Afati fillon të ecë nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor...”.*

53. Për sa i përket përmbushjes së këtyre kriterëve, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar, i cili kundërshton aktin e organit publik, përkatësisht Aktgjykimin [Rev.nr.223/2021] e 31 marsit 2022, të Gjykatës Supreme, pasi që ka shteruar të gjitha mjetet juridike. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu theksoi të drejtat dhe liritë që pretendon se i janë shkelur, në përputhje me kërkesat e nenit 48 (Saktësimi i kërkesës) të Ligjit dhe kërkesën e ka paraqitur në përputhje me afatet e përcaktuara në nenin 49 (Afatet) të Ligjit.

54. Përveç kësaj, Gjykata gjithashtu i referohet rregullit 34 (2) të Rregullores së Punës që përcakton:

*“(2) Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij”.*

55. Bazuar në praktikën gjyqësore të GjEDNj-së, por edhe të Gjykatës, një kërkesë mund të shpallet e papranueshme si “qartazi e pabazuar” në tërësinë e saj ose vetëm përkitazi me ndonjë pretendim specifik që një kërkesë mund të ngërthejë. Në këtë drejtim, është më e saktë t’iu referohet të njëjtave si “pretendime qartazi të pabazuara”. Këto të fundit, bazuar në praktikën gjyqësore të GjEDNj-së, mund të kategorizohen në katër grupe të veçanta: (i) pretendime që kategorizohen si pretendime “të shkallës së katërt”; (ii) pretendime që kategorizohen me një “mungesë të dukshme ose evidente të shkeljes”; (iii) pretendime “të pambështetura apo të paarsyetuara”; dhe në fund, (iv) pretendime

“konfuze dhe të paqarta” (shih, rastet e GjEDNJ-së, [Kemmachev kundër Francës, Kërkesa nr. 17621/91](#), kategoria (i), [Mentzen kundër Letonia, Kërkesa nr. 71074/01](#), kategoria (ii) dhe [Trofimchuk kundër Ukrainës, Kërkesa nr. 4241/03](#), kategoria (iii)).

56. Në kontekst të vlerësimit të pranueshmërisë së kërkesës, përkatësisht, në vlerësimin nëse kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, Gjykata fillimisht do të rikujtojë pretendimet përkatëse të parashtruesit të kërkesës, në vlerësimin e të cilave, Gjykata do të aplikojë standardet e praktikës gjyqësore të GjEDNJ-së, në harmoni me të cilën, në bazë të nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, ajo është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë.
57. Fillimisht, Gjykata thekson se thelbi i rastit ndërlidhet me kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës për tu kthyer në vendin e punës si konduktor në kompaninë Kosovatrans, nga e cila ishte larguar nga puna në vitin 1991 si pasojë e vendosjes së masave të dhunshme në Kosovë, si dhe kërkesës për kompensimin e pagave të papaguara. I njëjti ishte larguar bazuar në arsyetimin se ai kishte refuzuar të nënshkruajë deklaratën mbi pranimin e masave të përkohshme në këtë ndërmarrje, dhe se si pasojë e kësaj parashtruesi i kërkesës kishte filluar procese gjyqësore, me qëllimin për t'u kthyer në punë dhe në lidhje me kompensimin e të ardhurave personale. Rasti i parashtruesit deri tek marrja e vendimit të kontestuar të Gjykatës Supreme, kaloi nëpër 4 procedura gjyqësore. Rrjedhimisht, më 19 tetor 2006, Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit [Rev.nr.68/2006] kishte aprovuar kërkesën për kthim të detyruar në punë në detyrat e punës si konduktor, ndërsa pjesën e kërkesëpadisë së tij për kompensim të të ardhurave personale e kishte kthyer në rigjykim tek gjykata e shkallës së parë. Përfundimisht, Gjykata Supreme përmes vendimit të kontestuar thekson se të paditurës i mungon legjitimiteti pasiv, pasi që e njëjta përmes Ligjit Nr. 04/L-111 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike kishte kaluar në status të ndërmarrjes publike ku në pronësi të 100% të aksioneve është Komuna e Gjilanit, e cila në këtë kontest nuk është në cilësinë e palës së paditur.
58. Përderisa parashtruesi i kërkesës shpërfaqë pretendime për shkelje të të drejtave të tij të garantuara me nenin 31 të Kushtetutës, Gjykata vëren se i njëjti para Gjykatës i konteston konstatimet e Gjykatës së Apelit, duke pretenduar, në thelb shkelje të nenit 31 të Kushtetutës që kanë të bëjnë me mënyrën e interpretimit dhe zbatimit të ligjit material.

***(i) Lidhur me pretendimin për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës për sa i përket interpretimit të gabuar të ligjit***

59. Parashtruesi i kërkesës i konteston para Gjykatës konstatimet e Gjykatës së Supreme, duke pretenduar në thelb shkelje që kanë të bëjnë me mënyrën e interpretimit dhe zbatimit të ligjit material. Në këtë aspekt, parashtruesi i kërkesës, ndër të tjera, vë theks në interpretimin e gabuar të së drejtës materiale në kontekst të përcaktimit të çështjes së legjitimitetit pasiv të të paditurës duke theksuar që Gjykata “është dashur të aplikojë dispozitën e nenit 39 pika 2 të Ligjit për Ndërmarrje Publike 03/L-087 dhe t’ia vërtetojë paditësit të drejtën për kompensimin e të ardhurave personale, e drejtë kjo që i është mohuar paditësit padrejtësisht”.
60. Në shqyrtimin e këtyre pretendimeve, Gjykata thekson se të njëjtat në esencë ndërlidhen me zbatimin e gabuar të ligjit të aplikueshëm nga Gjykata Supreme, pretendime të cilat, Gjykata në përputhje me praktikën e saj gjyqësore dhe atë të GJEDNJ-së, i konsideron si “pretendime të shkallës së katërt”.
61. Në kontekst të kësaj kategorie pretendimesh, Gjykata thekson se bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, por edhe duke marrë parasysh veçoritë e saj, siç janë



përcaktuar përmes KEDNJ-së, parimin e subsidiaritetit dhe doktrinën e shkallës së katërt, ajo vazhdimisht e ka theksuar dallimin në mes të "*kushtetutshmërisë*" dhe "*ligjshmërisë*" dhe ka pohuar se nuk është detyrë e saj të merret me gabime të fakteve ose interpretimit dhe aplikimit të gabuar të ligjit, që pretendohet se janë bërë nga një gjykatë e rregullt, përveç dhe për aq sa gabimet e tilla mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë dhe/ose me KEDNJ. (Shih, në këtë kontekst, ndër të tjera, rastet e Gjykatës [KI96/21](#), parashtrues *Xhelal Zherka*, Aktvendim për Papranueshmëri i 23 shtatorit 2021, paragrafi 49; [KI145/20](#), parashtrues *Hafize Gashi*, Aktvendim për Papranueshmëri i 22 prillit 2021, paragrafi 33; [KI179/18](#), parashtrues *Belgjyzar Latifi*, Aktvendim për papranueshmëri i 23 korrikut 2020, paragrafi 68; [KI49/19](#), parashtrues *Shoqëria Aksionare Limak Kosovo International Airport SH.A.*, "*Adem Jashari*", Aktvendim i 31 tetorit 2019, paragrafi 47; [KI56/17](#), me parashtruese *Lumturije Murtezaj*, Aktvendim për papranueshmëri, i 18 dhjetorit 2017, paragrafi 35; dhe [KI154/17 dhe KIO5/18](#), me parashtrues, *Basri Deva, Afërdita Deva dhe Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar "Barbas"*, Aktvendim për papranueshmëri, i 12 gushtit 2019, paragrafi 60).

62. Gjykata gjithashtu ka pohuar vazhdimisht se nuk është roli i kësaj Gjykate të rishikojë konkluzionet e gjykatave të rregullta në lidhje me gjendjen faktike dhe zbatimin e të drejtës materiale dhe se ajo nuk mund të vlerësojë vetë faktet të cilat e kanë bërë një gjykatë të rregullt të marrë një vendim e jo një tjetër. Në të kundërtën, Gjykata do të vepronte si gjykatë e "*shkallës së katërt*", që do të rezultonte në shpërfilljen e kufijve të vendosur në juridiksionin e saj. (Shih, në këtë kontekst, rastin e GJEDNJ-së [García Ruiz kundër Spanjës](#), Aktgjykim i 21 janarit 1999, paragrafi 28 dhe referencat e përdoruar aty; dhe shih, gjithashtu rastet e Gjykatës, [KI145/20](#), cituar më lartë, paragrafi 34; [KI49/19](#), cituar më lart, paragrafi 48; dhe [KI154/17 dhe KIO5/18](#), cituar më lart, paragrafi 61).
63. Megjithatë Gjykata thekson se praktika gjyqësore e Gjykatës dhe e GJEDNJ-së gjithashtu përcaktojnë rrethana nën të cilat duhet të bëhen përjashtime nga ky qëndrim. Siç u theksua më lart, përderisa gjykatat e rregullta kanë detyrë primare të zgjidhin problemet rreth interpretimit të ligjit të aplikueshëm, roli i Gjykatës është që të sigurohet apo të verifikojë që efektet e këtij interpretimi të jenë në përputhje me Kushtetutën dhe KEDNJ-në. (Shih rastin e GJEDNJ-së, [Miragall Escolano dhe të tjerët kundër Spanjës](#), Aktgjykim i 25 janarit 2000, paragrafët 33-39; dhe shih, gjithashtu rastin e Gjykatës [KI154/17 dhe KIO5/18](#), cituar më lart, paragrafi 63). Në parim, një përjashtim i tillë, ndërlidhet me raste të cilat rezultojnë të jenë dukshëm arbitrare, duke përfshirë ato në të cilat, një gjykatë ka "*aplikuar ligjin në mënyrë qartazi të gabuar*" në një rast specifik dhe i cili mund të ketë rezultuar në "*konkluzione arbitrare*" apo "*qartazi të paarsyeshme*" për parashtruesin përkatës.
64. Për sa i përket pretendimeve të parashtruesit të kërkesës lidhur me çështjen e legjitimitetit pasiv të të paditurës, të cilën Gjykata Supreme e vlerësoi si të munguar në Aktgjykimin [Rev.nr.223/2021] e 31 marsit 2022, e njëjta kishte theksuar si në vijim:

*"Gjykata Supreme konstaton se zbatimi i gabuar i se drejtës materiale në këtë rast lidhet me faktin se e paditura si subjekti nga data 15.06.2012, në bazë të Ligjit Nr. 04/L-111 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike (i shpallur në Gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës nr. 13 datë 30.05.2012, hyrja në fuqi pas 15 ditësh pas shpalljes) sipas listës 2, është me status të ndërmarrjes publike ku në pronësi të 100% të aksioneve është Komuna e Gjilanit, e cila në këtë kontest nuk është në cilësinë e palës së paditur. Për këtë arsye Gjykata Supreme konsideron se e paditura nuk ka legjitimitet pasiv për të qenë palë e paditur në këtë çështje ngase tani më ajo është ndërmarrje publike në pronësi të Komunës së Gjilanit, në të cilën ligjërisht janë bartur të gjitha të drejtat dhe obligimet e saj. "*

*“Për më tepër, Gjykata Supreme gjen edhe se qëndron fakti se janë të kundërligjshme vendimet kontestuese me të cilat i është ndërprerë marrëdhënia e punës së paditësit në vitin 1991, ashtu siç ka konstatuar Gjykata Supreme e Kosovës me aktgjykimin e saj [Rev.nr. 68/2006] datë 25.01.1999, mirëpo tani e paditura nuk mund të ketë legjitimitet pasiv për të qenë e detyruar që paditësit t’ia paguajë të ardhurat personale kontestuese ngase përveç faktit që e paditura tani me është ndërmarrje publike në pronësi të Komunës së Gjilanit, ajo nuk ia ka ndërprerë paditësit marrëdhënien e punës, por ia ka ndërprerë paraardhësja e saj "Kosmet Prevoz" e cila tani më nuk ekziston, e as nuk ka ekzistuar dhe funksionuar pas vitit 1999, në njërin anë, ndërsa në anën tjetër "Kosovatransi", i cili si ndërmarrje ka ekzistuar më parë tek e cila ka qenë i punësuar paditësi, e pasardhës i saj është " Kosmet prevozi", nuk mban përgjegjësi për veprimet e kundërligjshme të ndërmarrjes "Kosmet Prevoz". Pas vitit 1999 "Kosovatransi" i Gjilanit, është krijuar si subjekt i ri, duke mos trashëguar borxhet dhe detyrimet e "Kosmet Prevozit" e cila në rastin konkret në bazë të aktgjykimit të lartpërmendur të Gjykatës Supreme të Kosovës kishte pas për detyrim sikur ekzistonte, që paditësit t’ia kompensoj të ardhurat personale. Kjo do të thotë që edhe për këto arsye, e paditura nuk ka legjitimitet pasiv, ndaj, edhe nuk është e detyruar që paditësit t’i kompensojë të ardhurat personale për periudhën kohore 1991-1999 pasi që këtë dëm material paditësit ajo nuk ia ka shkaktuar, atë ia ka shkaktuar një subjekt tjetër ekonomik.”*

65. Në këtë aspekt, Gjykata konsideron se Gjykata Supreme përmes vendimit të kontestuar kishte ndryshuar Aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë dhe të dytë, duke trajtuar dhe arsyetuar pretendimet e parashtruesit të kërkesës dhe palës së paditur, duke përfshirë edhe ato që ndërlidhen me interpretimin e gabuar të dispozitave ligjore, përkatësisht të çështjes së përcaktimit të legjitimitetit pasiv të paditurit. Nën dritën e të lartcekurave, Gjykata vëren se Gjykata Supreme kishte arsyetuar se përse e paditura nuk ka legjitimitet pasiv në këtë çështje kontestimore dhe se e njëjta nuk është e detyruar ligjërisht që parashtruesit të kërkesës t’i paguajë të ardhurat personale për periudhën e kohore 1991-1999. Gjithashtu Gjykata Supreme kishte sqaruar që të paditurës i mungonte legjitimiteti pasiv për të qenë palë e paditur në këtë çështje ngase tani më ajo ishte ndërmarrje publike në pronësi të Komunës së Gjilanit, në të cilën ligjërisht janë bartur të gjitha të drejtat dhe obligimet e saj.
66. Në vijim, për sa i përket pretendimit të parashtruesit të kërkesës, sipas të cilit Gjykata Supreme “duke marrë dy vendime të ndryshme dhe kontradiktore në dy raste të ndryshme të revizionit, ka shkelur rëndë parimin e sigurisë juridike të palëve në procedurë”, Gjykata thekson se ndryshimi i rezultatit të një çështjeje për shkak të një procedure të rishqyrtuar nuk do të thotë që nuk ka siguri juridike, në fakt është pikërisht qëllimi i një procedure të rishqyrtuar për të siguruar që të gjitha provat dhe dëshmitë të trajtohen në mënyrë të duhur dhe që rrjedhimisht në shumë raste të çojnë në një rezultat tërësisht të ndryshëm. Megjithatë, ky ndryshim nuk do të thotë që ka shkelje të nenit 31 të Kushtetutës. Në fakt, nëpërmjet një procesi të rishqyrtuar, në këtë rast, Gjykata Supreme gjeti se pala nuk ka legjitimitet pasiv, pra nuk mund të kërkohej nga ndërmarrja diçka për të cilën nuk mund të jetë subjekt për atë çështje.
67. Në këtë kontekst, Gjykata rikujton se ajo vet nuk mund të shndërrohet në gjykatë të faktit dhe t’u tregojë gjykatave të rregullta se cila do të ishte mënyra më e përshtatshme e zbatimit të së drejtës materiale, sepse një kompetencë e tillë, si rregull, i takon gjykatave të juridiksionit të rregullt që ta bëjnë. Gjykata thekson se ajo mund të ndërhyjë vetëm atëherë kur arsyetimi i vendimeve të gjykatave të rregullta është tejet arbitrar dhe i pajustificueshëm, çfarë në rrethanat konkrete nuk kemi të bëjmë me vendime qartazi arbitrare ose të pajustificuara.
68. Lidhur me pretendimin e parashtruesit të kërkesës për zbatim të gabuar të së drejtës materiale, Gjykata thekson se parashtruesi i kërkesës, përtej pretendimeve për shkelje të



nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, si rezultat i vërtetimit të gabuar të fakteve dhe interpretimit të gabuar të ligjit, nuk mbështet mjaftueshëm dhe as nuk argumentoi para Gjykatës, se si ky interpretim i ligjit të aplikueshëm nga Gjykata e Apelit, mund të ketë qenë “qartazi i gabuar”, duke rezultuar në “konkluzione arbitrare” apo “qartazi të paarsyeshme” për parashtruesin e kërkesës apo se procedurat para gjykatave të rregullta, në tërësinë e tyre, mund të mos kenë qenë të drejta apo edhe arbitrare. Përveç kësaj, Gjykata vlerëson se Gjykata Supreme ka marrë parasysh të gjitha faktet dhe rrethanat e rastit, pretendimet e parashtruesit kërkesës dhe i ka arsyetuar të njëjtat (shih, në këtë kontekst, rastet e Gjykatës [KI64/20](#), parashtrues, *Asllan Meka*, Aktvendim për papranueshmëri i 3 gushtit 2020, paragrafi 41; dhe [KI37/21](#) parashtrues, *Isa Tusha, Naser Tusha dhe Miradije Tusha*, Aktvendim për papranueshmëri i 8 shtatorit 2021, paragrafi 67).

69. Andaj, Gjykata nga shtjellimet e mësipërme konsideron se parashtruesi i kërkesës thjeshtë është i pakënaqur me rezultatin e procedurës pranë gjykatave të rregullta, megjithatë pakënaqësia e tij nuk mund vetvetiu të ngrejë pretendim të argumentueshëm për shkeljen e të drejtave dhe lirive themelore të garantuara me Kushtetutë (shih, rastin e GjEDNJ-së [Mezotur-Tiszazugi Tarsulat kundër Hungarisë, kërkesa nr. 5503/02](#), Aktgjykimi i 26 korrikut 2005, paragrafi 21).
70. Prandaj, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij se gjykatat e rregullta mund të kenë aplikuar ligjin në mënyrë të gabuar, dhe rrjedhimisht pretendimet e tij për interpretimin dhe aplikimin e gabuar të ligjit të aplikueshëm, kualifikohen si pretendime që bien në kategorinë e “shkallës së katërt” dhe si të tilla, reflektojnë pretendime në nivel të “ligjshmërisë” dhe nuk janë argumentuar në nivel të “kushtetutshmërisë”. Për pasojë, të njëjtat janë qartazi të pabazuara në baza kushtetuese, siç është përcaktuar përmes paragrafit (2) të rregullit 34 të Rregullores së punës.

## PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.1 dhe 113.7 të Kushtetutës, nenin 20 të Ligjit dhe rregullat 34 (2) dhe 48 (1) (b) të Rregullores së punës, më 28 maj 2024, njëzëri:

## VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë Aktvendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë Aktvendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky Aktvendim hyn në fuqi në ditën e shpalljes në Gazetën Zyrtare, në pajtim me paragrafin 5 të nenit 20 të Ligjit.

Gjyqtarja raportuese

Selvete Gërxxhaliu Krasniqi



Kryetare e Gjykatës Kushtetuese

Gresa Caka-Nimani